

**Akti i Themelimit i
"Ignite Idea" sh.p.k.**

Në mbështetje të legjislacionit shqiptarë, në ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në dokument referuar si "Ligji", hartohet Akti i Themelimit, me kushtet që përçaktohen si më poshtë:

Neni 1

Baza ligjore

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar Ignite Idea, në vijim referuar si "Shoqëria" themelohet sipas formës dhe kuptimit të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", pjesa IV – Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe në përputhje të plotë me Kodin Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Emërtimi

Shoqëria quhet Ignite Idea.

Neni 3

Sigla (Logo)

Forma dhe përmbajtja e siglës (logos) përcaktohet nga organet drejtuese të shoqërisë.

Neni 4

Vula

Forma dhe përmbajtja e vulës përcaktohet nga organet drejtuese të shoqërisë. Vula figuron në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del prej shoqërisë. Vula mbahet dhe administrohet nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 5


Selia

Selia është në adresën: Rruga GRAMSHI 00970045; Nd. 11; H. 1; CËRRIK; CËRRIK; 3007; CËRRIK. Kjo adresë mund të ndryshojë në varësi të veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 6

Faqja web

Faqja web është www.igniteidea.al.

Ronald Gola


Neni 7

Posta elektronike

Posta elektronike që mund të përdoret për qëllime të komunikimit elektronik është info@igniteidea.al.

Neni 8

Kohëzgjatja

Shoqëria do të veprojë në një afat kohor të pacaktuar. Përfundimi i veprimtarisë bëhet me vendim të Bordit të Ortakëve.

Neni 9

Qëllimi dhe Fushat e veprimtarisë

Shoqëria aspiron të realizojë aktivitetet e mëposhtme:

1. Ofrimin e shërbimeve që plotësojnë kërkesën konsumatore.
2. Konsultimin në fushën e IT-së për konsumatorët.
3. Kuptimin e nevojave të konsumatorëve dhe ofrimin e mundësive teknologjike që i plotësojnë këto nevoja.
4. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e aplikacioneve për konsumatorët.

Neni 10

Data e themelimit

Shoqëria themelohet më datë 11 prill 2022.

Neni 11


Themeluesi

Shoqëria krijohet me Aktin e Themelimit, nënshkruar me vullnetin dhe iniciativën e lirë të themeluesit të saj të vetëm **Z. Ronaldo Çala**.

Neni 12

Kapitali fillestarë

Kapitali themeltar fillestarë i shoqërisë është **100 Lekë**, i përbërë nga 1 kuotë e vetme me vlerë 100 Lekë. Kapitali përbëhet 100% nga kontributi i themeluesit të vetëm të shoqërisë.

Ronaldo Çala


Neni 13
Organet drejtuese

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Bordi i Ortakëve
2. Drejtori Ekzekutiv

Organi i vetëm vendimmarrës i Ignite Idea SH.P.K. është Bordi i Ortakëve.
Drejtor Ekzekutiv emërohet ortaku i vetëm **Z. Ronaldo Çala**, i biri i Agronit, lindur në Cërrik më 28.08.1998, banues në Tiranë. Mandati ka afat 5.

Neni 14
Përfaqësimi ligjor

Perfaqësues ligjor i Shoqërisë është Drejtori Ekzekutiv. Nëse ai për arsye të ndryshme nuk është i disponueshëm, ia kalon këtë të drejtë një punonjësi tjetër të Shoqërisë me anë të një dokumenti të shkruar, ku përcakton shprehimisht kompetencat që ka deleguar dhe shtrirjen kohore të vlefshmërisë së delegimit.

Ky Akt hartohet në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 11 prill 2022.

Themeluesi:

Ronaldo Çala

Ronaldo Çala
